

VENDIM
Nr. 792, datë 7.10.2020

**PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE TË KRITEREVE TË POSAÇME TË
LICENCIMIT, DOKUMENTEVE SHOQËRUESE, NËNKATEGORIVE TË
LICENCAVE, PROCEDURAVE PËR DHËNIEN, PEZULLIMIN OSE
REVOKIMIN, SI DHE KUOTIZACIONIT VJETOR TË LICENCAVE PËR
NDËRHJRJET NË PASURITË KULTURORE MATERIALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 82, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Ky vendim përcakton dhe shtrin fushën e veprimit në

- a) llojet, kategoritë dhe nënkategoritë e licencave për veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale;
- b) përcaktimin e kushteve, kritereve të posaçme dhe dokumenteve shoqëruese për licencimin e individëve dhe licencimin e personave fizikë dhe juridikë, për kryerjen e veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale;
- c) procedurat për dhënie, pezullimin, revokimin dhe kuotizacionin e licencave për veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale.

II. LLOJET, KATEGORITË DHE NËNKATEGORITË E LICENCAVE DHE KUSHTET PËR LICENCIM

1. Licenca për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale është akti administrativ që i njeh titullarit të saj të drejtën të fillojë e të ushtrojë tipin e veprimtarisë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të.

2. Llojet e licencave për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale janë në

- a) projektim (P);
- b) zbatim (Z);
- c) mbikëqyrje dhe kolaudim (MK).

3. Kategoritë e licencave për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale janë si më poshtë vijon:

a) licencë për kryerjen e veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, të arkitekturës/ndërtimore – (A);

b) licencë për kryerjen e veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, vepra arti – (V).

4. Nënkatëgoritë e licencave për individin në projektim (P) në veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, në kategoritë (A) dhe (V), janë si më poshtë vijon:

- a) P/A/1. Projektim në konservim dhe restaurim i rrënojave/siteve arkeologjike;
- b) P/A/2. Projektim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve me karakter mbrojtës;
- c) P/A/3. Projektim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së kultit;
- ç) P/A/4. Projektim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve inxhinierike;
- d) P/A/5. Projektim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së traditës (vernakulare);
- dh) P/A/6. Projektim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së projektuar;
- e) P/A/7. Projektim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane;
- ë) P/V/1. Projektim në konservim dhe restaurim i mozaikëve;
- f) P/V/2. Projektim në konservim dhe restaurim i pikturave murale dhe shkëmbore;

- g) P/V/3. Projektim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në dru;
- gj) P/V/4. Projektim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në allçi, gur, qeramikë;
- h) P/V/5. Projektim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në metal, qelq;
- i) P/V/6. Projektim në konservim dhe restaurim të objekteve tekstil, lëkurë, pergamenë, telajo, letër.

5. Nënkatëgoritë e licencave për individin në zbatim (Z) në veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, në katëgoritë (A) dhe (V) janë si më poshtë vijon:

- a) Z/A/1. Zbatim në konservim dhe restaurim i rrënojave/siteve arkeologjike;
- b) Z/A/2. Zbatim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve me karakter mbrojtës;
- c) Z/A/3. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së kultit;
- ç) Z/A/4. Zbatim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve inxhinierike;
- d) Z/A/5. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së traditës (vernakulare);
- dh) Z/A/6. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së projektuar;
- e) Z/A/7. Zbatim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane;
- ë) Z/V/1. Zbatim në konservim dhe restaurim i mozaikëve;
- f) Z/V/2. Zbatim në konservim dhe restaurim i pikturave murale dhe shkëmbore;
- g) Z/V/3. Zbatim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në dru;
- gj) Z/V/4. Zbatim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në allçi, gur, qeramikë;
- h) Z/V/5. Zbatim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në metal, qelq;
- i) Z/V/6. Zbatim në konservim dhe restaurim i objekteve tekstil, lëkurë, pergamenë, telajo, letër.

6. Nënkatëgoritë e licencave për individin në mbikëqyrje dhe kolaudim (MK) në veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, në katëgoritë (A) dhe (V), janë si më poshtë vijon:

- a) MK/A/1. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i rrënojave/siteve arkeologjike;
- b) MK/A/2. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve me karakter mbrojtës;
- c) MK/A/3. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së kultit;
- ç) MK/A/4. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve inxhinierike;
- d) MK/A/5. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së traditës (vernakulare);
- dh) MK/A/6. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së projektuar;
- e) MK/A/7. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane;
- ë) MK/V/1. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i mozaikëve;
- f) MK/V/2. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i pikturave murale dhe shkëmbore;
- g) MK/V/3. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në dru;
- gj) MK/V/4. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në allçi, gur, qeramikë;
- h) MK/V/5. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim të veprave të artit në metal, qelq;
- i) MK/V/6. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i objekteve tekstil, lëkurë, pergamenë, telajo, letër.

7. Nënkatëgoritë e licencave për personin fizik (F-) në projektim (P) në veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, në katëgoritë (A) dhe (V), janë si më poshtë vijon:

- a) F-P/A/1. Projektim në konservim dhe restaurim i rrënojave/siteve arkeologjike;
- b) F-P/A/2. Projektim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve me karakter mbrojtës;
- c) F-P/A/3. Projektim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së kultit;

- c) F-P/A/4. Projektim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve inxhinierike;
- d) F-P/A/5. Projektim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së traditës (vernakulare);
- dh) F-P/A/6. Projektim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së projektuar;
- e) F-P/A/7. Projektim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane;
- ë) F-P/V/1. Projektim në konservim dhe restaurim i mozaikëve;
- f) F-P/V/2. Projektim në konservim dhe restaurim i pikturave murale dhe shkëmbore;
- g) F-P/V/3. Projektim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në dru;
- gj) F-P/V/4. Projektim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në allçi, gur, qeramikë;
- h) F-P/V/5. Projektim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në metal, qelq;
- i) F-P/V/6. Projektim në konservim dhe restaurim i objekteve tekstil, lëkurë, pergamenë, telajo, letër.

8. Nënkatëgoritë e licencave për personin fizik (F-) në zbatim (Z) në veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, në katëgoritë (A) dhe (V), janë:

- a) F-Z/A/1. Zbatim në konservim dhe restaurim të rrënojave/siteve arkeologjike;
- b) F-Z/A/2. Zbatim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve me karakter mbrojtës;
- c) F-Z/A/3. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së kultit;
- c) F-Z/A/4. Zbatim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve inxhinierike;
- d) F-Z/A/5. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së traditës (vernakulare);
- dh) F-Z/A/6. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së projektuar;
- e) F-Z/A/7. Zbatim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane;
- ë) F-Z/V/1. Zbatim në konservim dhe restaurim i mozaikëve;
- f) F-Z/V/2. Zbatim në konservim dhe restaurim i pikturave murale dhe shkëmbore;
- g) F-Z/V/3. Zbatim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në dru;
- gj) F-Z/V/4. Zbatim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në allçi, gur, qeramikë;
- h) F-Z/V/5. Zbatim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në metal, qelq;
- i) F-Z/V/6. Zbatim në konservim dhe restaurim i objekteve tekstil, lëkurë, pergamenë, telajo, letër.

9. Nënkatëgoritë e licencave për personin fizik (F-) në mbikëqyrje dhe kolaudim (MK) në veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, në katëgoritë (A) dhe (V), janë si më poshtë vijon:

- a) F-MK/A/1. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i rrënojave/siteve arkeologjike;
- b) F-MK/A/2. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve me karakter mbrojtës;
- c) F-MK/A/3. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së kultit;
- c) F-MK/A/4. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve inxhinierike;
- d) F-MK/A/5. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së traditës (vernakulare);
- dh) F-MK/A/6. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së projektuar;
- e) F-MK/A/7. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane;
- ë) F-MK/V/1. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i mozaikëve;
- f) F-MK/V/2. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i pikturave murale dhe shkëmbore;
- g) F-MK/V/3. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në dru;
- gj) F-MK/V/4. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në allçi, gur, qeramikë;

h) F-MK/V/5. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në metal, qelq;

i) F-MK/V/6. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i objekteve tekstil, lëkurë, pergamenë, telajo, letër.

10. Nënkatëgoritë e licencave për personin juridik (N-) në projektim (P) në veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, në katëgoritë (A) dhe (V) janë si më poshtë vijon:

- a) N-P/A/1. Projektim në konservim dhe restaurim i rrënojave/siteve arkeologjike;
- b) N-P/A/2. Projektim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve me karakter mbrojtës;
- c) N-P/A/3. Projektim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së kultit;
- ç) N-P/A/4. Projektim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve inxhinierike;
- d) N-P/A/5. Projektim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së traditës (vernakulare);
- dh) N-P/A/6. Projektim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së projektuar;
- e) N-P/A/7. Projektim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe)

brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane;

- ë) N-P/V/1. Projektim në konservim dhe restaurim i mozaikëve;
- f) N-P/V/2. Projektim në konservim dhe restaurim i pikturave murale dhe shkëmbore;
- g) N-P/V/3. Projektim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në dru;
- gj) N-P/V/4. Projektim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në allçi, gur, qeramikë;
- h) N-P/V/5. Projektim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në metal, qelq;
- i) N-P/V/6. Projektim në konservim dhe restaurim i objekteve tekstil, lëkurë, pergamenë, telajo, letër.

11. Nënkatëgoritë e licencave për personin juridik (N-) në zbatim (Z) në veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, në katëgoritë (A) dhe (V), janë si më poshtë vijon:

- a) N-Z/A/1. Zbatim në konservim dhe restaurim të rrënojave/siteve arkeologjike;
- b) N-Z/A/2. Zbatim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve me karakter mbrojtës;
- c) N-Z/A/3. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së kultit;
- ç) N-Z/A/4. Zbatim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve inxhinierike;
- d) N-Z/A/5. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së traditës (vernakulare);
- dh) N-Z/A/6. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së projektuar;
- e) N-Z/A/7. Zbatim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe)

brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane;

- ë) N-Z/V/1. Zbatim në konservim dhe restaurim i mozaikëve;
- f) N-Z/V/2. Zbatim në konservim dhe restaurim i pikturave murale dhe shkëmbore;
- g) N-Z/V/3. Zbatim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në dru;
- gj) N-Z/V/4. Zbatim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në allçi, gur, qeramikë;
- h) N-Z/V/5. Zbatim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në metal, qelq;
- i) N-Z/V/6. Zbatim në konservim dhe restaurim i objekteve tekstil, lëkurë, pergamenë, telajo, letër.

12. Nënkatëgoritë e licencave për personin juridik (N-) në mbikëqyrje dhe kolaudim (MK) në veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, në katëgoritë (A) dhe (V), janë si më poshtë vijon:

a) N-MK/A/1. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i rrënojave/siteve arkeologjike;

b) N-MK/A/2. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve me karakter mbrojtës;

c) N-MK/A/3. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së kultit;

ç) N-MK/A/4. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve inxhinierike;

d) N-MK/A/5. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së traditës (vernakulare);

dh) N-MK/A/6. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së

projektuar;

e) N-MK/A/7. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane;

ë) N-MK/V/1. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i mozaikëve;

f) N-MK/V/2. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i pikturave murale dhe shkëmbore;

g) N-MK/V/3. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në dru;

gj) N-MK/V/4. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në allçi, gur, qeramikë;

h) N-MK/V/5. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në metal, qelq;

i) N-MK/V/6. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i objekteve tekstil, lëkurë, pergamenë, telajo, letër.

A. Kushtet e përgjithshme për pajisjen me licencë

1. Çdo individ, i cili ka zotësinë e plotë juridike për të vepruar, si dhe çdo person fizik apo juridik i regjistruar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi për veprimtaritë tregtare, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për pajisje me licencë në projektim, zbatim, mbikëqyrje e kolaudim.

2. Subjekti dorëzon kërkesën e plotë për pajisjen me licencë, bashkë me dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për përfitimin e licencës, pranë Sekretarisë Teknike të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (në vijim "KKTKM"), si dhe dokumentet shoqëruese të kërkuara në këtë vendim për të provuar përmbushjen e kriterëve të posaçme.

B. Kriteret e posaçme për licencimin për individ

1. Për të përfituar licencë për projektim të nënkategorive sipas pikës 4, të kreut II, të këtij vendimi, individi duhet:

a) të ketë një nga nivelet e edukimit sipas aneksit 1;

b) të ketë eksperiencë pune në profesion sipas aneksit 1;

c) të plotësojë kriteret sipas aneksit 1, përkatësisht:

i. për eksperiencën në institucion të specializuar në kuptim të ligjit nr. 27/2018, të lidhura me nënkategorinë;

ii. për specializimet ose kurset profesionale (teorike) të lidhura me nënkategorinë;

iii. për autorësi ose bashkautorësi në hartim projektesh konservim-restaurim, të miratuara sipas legjislacionit shqiptar në fushën e trashëgimisë kulturore të lidhura me nënkategorinë.

2. Për të përfituar licencë për zbatim të nënkategorive sipas pikës 5, të kreut II, të këtij vendimi, individi duhet:

a) të ketë një nga nivelet e edukimit sipas aneksit 2;

b) të ketë eksperiencë pune në profesion sipas aneksit 2;

c) të plotësojë kriteret sipas aneksit 2, përkatësisht, për:

i. eksperiencën në institucion të specializuar në kuptim të ligjit nr. 27/2018, të lidhura me nënkategorinë;

ii. specializimet ose kurset profesionale (kampe zbatimi restaurimi) të lidhura me nënkategorinë;

iii. autorësi ose bashkautorësi në hartim projektesh konservim-restaurim, të miratuara sipas legjislacionit shqiptar të trashëgimisë kulturore të lidhura me nënkategorinë.

3. Për të përfituar licencë për mbikëqyrje dhe kolaudim të nënkategorive sipas pikës 6, të kreut II, të këtij vendimi, individi duhet:

a) të ketë një nga nivelet e edukimit sipas aneksit 3;

b) të ketë eksperiencë pune në profesion sipas aneksit 3;

c) të plotësojë kriteret sipas aneksit 3, përkatësisht, për:

i. eksperiencën në institucion të specializuar në kuptim të ligjit nr. 27/2018, të lidhura me

nënkategorinë;

ii. specializimet ose kurset profesionale (kampe zbatimi restaurimi) të lidhura me nënkategorinë;

iii. autorësi ose bashkautorësi në hartim projektesh konservim-restaurim të miratuara sipas legjislacionit shqiptar të trashëgimisë kulturore të lidhura me nënkategorinë.

C. Kriteret e posaçme për licencim për personin fizik/juridik

1. Kriteret e posaçme për licencim për personin fizik (F-) për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale janë si më poshtë vijon:

a) Të ketë të punësuar si drejtues teknik individin e licencuar në fushën e veprimtarisë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, që plotëson kushtet e posaçme për kategorinë/nënkategorinë e licencës, sipas kreut II të këtij vendimi. Kontrata e punësimit ndërmjet personit fizik dhe individit të licencuar nuk mund të jetë më pak se 1 (një) vit. Personi fizik licencohet për të njëjtën kategori/nënkategori të licencës për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale që disponon drejtuesi teknik;

b) Në rastin kur personi fizik zotëron licencë si individ në fushën e veprimtarisë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, nuk ka nevojë të punësojë një drejtues teknik, sipas parashikimit të shkronjës “a”, të kësaj pike.

2. Kriteret e posaçme për licencim për personin juridik (N-), për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, janë si më poshtë vijon:

a) Të ketë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë si person juridik në veprimtarinë kryesore projektim dhe/ose zbatim dhe/ose mbikëqyrje dhe kolaudim të punimeve të ndërtimit dhe/ose restaurimin e veprave të artit;

b) Të ketë të punësuar si drejtues teknik individ të licencuar në fushën e veprimtarisë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, që plotëson kushtet e posaçme për kategorinë/nënkategorinë e licencës, sipas kreut II të këtij vendimi. Kontrata e punësimit ndërmjet personit juridik dhe individit të licencuar nuk mund të jetë më pak se 1 (një) vit. Personi juridik licencohet për të njëjtën kategori/nënkategori të licencës për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale që disponon drejtuesi teknik.

Ç. Kufizime për dhënien dhe përdorimin e licencës

1. Licenca nuk lejohet të tjetërsohet apo të trashëgohet nga një subjekt (individ, person fizik, person juridik) tek tjetri.

2. Individët e licencuar në fushën e veprimtarisë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, të cilët punojnë si drejtues teknikë pranë një personi fizik ose juridik të licencuar për zbatim, nuk mund të përdorin licencë si individë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit në konservim e restaurim, gjatë kohës që janë të punësuar në këtë pozicion.

3. Kur ndodh ndryshimi faktik i të dhënave të përcaktuara në licencë, të cilat kanë të bëjnë me kriteret e licencimit, pavarësisht se mund të cenohet apo jo këto kritere, subjekti (individ, person fizik, person juridik) duhet të njoftojë menjëherë në formë zyrtare, Sekretarinë Teknike të KKTKM-së, pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (në vijim “IKTK”).

4. Kur vlerësohet se dokumentet e dorëzuara nga subjekti (individ, person fizik, person juridik) provojnë përmbushjen përsëri të kritereve të licencimit, atëherë KKTKM-ja miraton ndryshimet dhe subjekti pajiset me licencën e ndryshuar. Përdorimi i licencës pezullohet për periudhën deri në miratimin e ndryshimeve dhe pajisjen me licencën e ndryshuar.

D. Afatet e vlefshmërisë së licencës

1. Licenca për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale është pa afat, për të gjitha subjektet e licencuara.

2. Subjekti, person fizik apo juridik, njofton në formë zyrtare në Sekretarinë Teknike të KKTKM-së, pranë IKTK-së:

a) menjëherë, kur kontrata e punësimit të drejtuesit teknik ndërpritet përpara afatit;

b) të paktën 45 (dyzet e pesë) ditë përpara mbarimit të kontratës së punësimit të drejtuesit teknik, nëse kjo kontratë do të ripërtërihet;

c) të paktën 45 (dyzet e pesë) ditë përpara mbarimit të kontratës së punësimit të drejtuesit teknik, nëse kjo kontratë nuk do të ripërtërihet.

III. DOKUMENTACIONI SHOQËRUES PËR PAJISJEN ME LICENCË

A. Dokumente shoqëruese për pajisjen me licencë për individin

Kërkesa për pajisje me licencë për herë të parë për individin, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet e posaçme të përcaktuara në këtë vendim, shoqërohet me:

- a) kërkesën për pajisje me licencë, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;
- b) kopjen e dokumentit të identifikimit;
- c) dokumentin që vërteton kohën/vitet e punës (librezën e punës apo dokumente të tjera që vërtetojnë kohën/vitet e punës);
- ç) vetëdeklarimin mbi gjendjen e tij gjyqësore dhe penale;
- d) dy fotografi me përmasa 3x4 cm;
- dh) kopjen e diplomave që zotëron, certifikata kursi apo specializimi, të njësuara me origjinalin.

B. Dokumente shoqëruese për pajisjen me licencë për personin fizik

Kërkesa për pajisje me licencë për herë të parë për personin fizik, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet e posaçme të përcaktuara në këtë vendim, shoqërohet me:

- a) kërkesën për pajisje me licencë, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;
- b) certifikatën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- c) kopjen e dokumentit të identifikimit të aplikuesit;
- ç) dokumentin që vërteton kohën/vitet e punës (librezën e punës apo dokumente të tjera që vërtetojnë kohën/vitet e punës) për aplikuesin;
- d) vetëdeklarimin mbi gjendjen gjyqësore dhe penale;
- dh) dy fotografi me përmasa 3x4 cm;
- e) kopjen e diplomave që zotëron, certifikata kursi apo specializimi, të njësuara me origjinalin.
- ë) në rastin e punësimit të drejtuesit teknik, kontratën e lidhur ndërmjet personit fizik dhe drejtuesit teknik të licencuar në fushën e veprimtarisë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, të hartuar përpara noterit;
- f) vetëdeklarimin nga drejtuesi teknik ose nga personi fizik (në rastin kur personi fizik zotëron licencë në fushën e veprimtarisë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale), për:
 - i. gjendjen gjyqësore dhe penale;
 - ii. gjendjen në lidhje me punësimin si drejtues teknik në persona fizikë apo juridikë të tjerë;
 - iii. marrëdhënien e tij të punës me institucionet shtetërore qendrore, vendore, të pavarura apo persona juridikë publikë të tjerë.

C. Dokumente shoqëruese për pajisje me licencë për personin juridik

Kërkesa për pajisje me licencë për herë të parë për personin juridik, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet e posaçme të specifikuara në këtë vendim, shoqërohet me:

- a) kërkesën për pajisje me licencë, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;
- b) certifikatën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- c) vetëdeklarimin mbi gjendjen gjyqësore dhe penale të anëtarëve të organit administrativ, aksionarit ose ortakut, të personit që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda personit juridik;
- ç) kontratën e punësimit ndërmjet përfaqësuesit ligjor të personit juridik dhe drejtuesit teknik të licencuar në fushën e veprimtarisë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, të hartuar përpara noterit;
- d) vetëdeklarimin nga drejtuesi teknik, për:
 - i. gjendjen gjyqësore dhe penale;
 - ii. gjendjen në lidhje me punësimin si drejtues teknik në persona fizikë apo juridikë të tjerë;
 - iii. marrëdhënien e tij të punës me institucionet shtetërore qendrore, vendore, të pavarura apo persona juridikë publikë të tjerë.

Ç. Dokumente shoqëruese në rast ndryshimi të licencës

1. Kërkesa për pajisje me shtesa në kategori ose nënkategori dhe për ndryshim të licencës shoqërohet me:

a) kërkesën për pajisje me shtesa në kategori ose nënkategori dhe ndryshim të licencës, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;

b) dokumentacionin përkatës që provon përmbushjen e kriterëve për kategorinë/nënkategorinë e kërkuar ose për ndryshimet.

2. Në rastin kur ndryshimi që kërkohet ka lidhje me shtesa në kategori ose nënkategori, me qëllim pajisjen me licencë të re, subjekti duhet të dorëzojë licencën ekzistuese. Licenca ekzistuese shpallet e pavlefshme dhe lëshohet licencë e re me shtesat. Licenca e shpallur e pavlefshme shenjohehet nga Sekretaria Teknike e KKTKM-së me prerje në anë dhe arkivohet në dosjen e subjektit.

3. Në rastin kur ndryshimi që kërkohet ka lidhje me ndërrimin e drejtuesit teknik, përfaqësuesve ligjorë, ndryshim të emrit apo të selisë, mbarimin e afatit të kontratës së punësimit apo ripërtëritjen e afatit të kontratës së punësimit, me qëllim pajisjen me licencë të re, subjekti duhet të dorëzojë licencën ekzistuese. Licenca ekzistuese shpallet e pavlefshme dhe lëshohet licencë e re. Licenca e shpallur e pavlefshme shenjohehet nga Sekretaria Teknike e KKTKM-së me prerje në anë dhe arkivohet në dosjen e subjektit.

D. Dokumente shoqëruese për pajisje me zëvendësim licence në rast humbjeje ose dëmtimi të ekzistueses

1. Kërkesa për pajisjen me zëvendësim licence, në rast humbjeje ose dëmtimi të ekzistueses, shoqërohet me:

a) kërkesën për pajisje me zëvendësim licence në rast humbjeje ose dëmtimi të ekzistueses, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;

b) dy fotografi për dokument.

2. Në rastin kur kërkesa ka lidhje me zëvendësimin e licencës së dëmtuar, me qëllim pajisjen me licencë të re, subjekti duhet të dorëzojë të dëmtuarën.

3. Licenca e dëmtuar ose e humbur shpallet e pavlefshme dhe lëshohet e re me të dhënat e njëjta dhe me datë lëshimi të re.

IV. PROCEDURAT PËR DHËNIEN, PEZULLIMIN OSE REVOKIMIN E LICENCËS PËR VEPRIMTARI NDËRHYRËSE NË PASURITË KULTURORE MATERIALE

A. Dorëzimi dhe pranimi i kërkesave

1. Kërkesa për licencë, si dhe dokumentet shoqëruese të saj dërgohen nëpërmjet sistemit informatik të integruar për shërbimet e licencimit për veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, që funksionon pranë portalit unik të shërbimeve qeveritare *e-Albania*.

2. Dokumentet për licencë, që ngarkohen në sistem, duhet të jenë

a) origjinale ose kopje të njësuara me origjinalin;

b) në gjuhën shqipe ose të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes zyrtar dhe të njësuara me origjinalin;

c) për rastet e dokumenteve të huaja, kopje të vërtetuara nga një autoritet publik i juridiksionit të huaj (zyrtar/noter). Është detyrim të vërtetohet ekzistenca e tyre si zyrtarë apo noterë, nëpërmjet legalizimit apo apostilimit, sipas ligjeve në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

3. Pagesa e tarifës për përfitimin e licencës kryhet nëpërmjet sistemit informatik të integruar për shërbimet e licencimit për veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, që funksionon pranë portalit unik të shërbimeve qeveritare *e-Albania* ose pranë çdo banke të nivelit të dytë, nëpërmjet formularit të faturës për arkëtim.

4. Paraqitja fizike e një apo disa dokumenteve pranë sportelit unik do të kryhet vetëm në këto raste:

a) Për dorëzimin e fotografive të individit që aplikon, të cilat dorëzohen fizikisht nga aplikuesi, deri në momentin e tërheqjes së formularit të licencës;

b) Për dorëzimin e licencës paraardhëse, në rastet e parashikuara në këtë vendim;

c) Kur kërkohet verifikim i dokumentit/dokumenteve nga Sekretaria Teknike e KKTKM-së.

B. Shqyrtimi i kërkesave për licencim

1. Kërkesa për licencim ose revokim të licencës për shtesa në kategori/nënkategori dhe ndryshim të licencës, si dhe për pajisje me zëvendësim licence në rast humbjeje ose dëmtimi të ekzistueses administrohet nga Sporteli Unik dhe Sekretaria Teknike e KKTKM-së, pranë IKTK-së.

2. Procedura e administrimit të kërkesës dhe e shqyrtimit të saj deri në vendimmarrje, me miratim ose jo të kërkesës, realizohet sipas rregullave të funksionimit të KKTKM-së, përcaktuar në “Rregulloren për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të saj”, miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

3. KKTKM-ja merr vendim mbi kërkesën sipas rastit, licencim ose revokim të licencës për shtesa në kategori/nënkategori dhe ndryshim të licencës, si dhe për pajisje me zëvendësim licence në rast humbjeje ose dëmtimi të ekzistueses, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga regjistrimi i kërkesës.

4. Ndaj vendimit të KKTKM-së mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

5. Sekretaria Teknike bën shpërndarjen e licencave të interesuarve jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e urdhrit të ministrit, nëpërmjet shërbimit postar ose licencat tërhiqen nga vetë personi i licencuar apo nga persona të autorizuar me akt noterial për të kryer një veprim të tillë apo personat e autorizuar nga personi juridik. Kopja e autorizimit depozitohet në dosjen që arkivohet.

6. Licenca e miratuar për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale për shtesa në kategori/nënkategori dhe ndryshim të licencës, për pajisje me zëvendësim licence në rast humbjeje ose dëmtimi të ekzistueses, si dhe çdo vendim për pezullim ose revokim të licencës, regjistrohet në Regjistrin e Licencave për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, i cili administrohet nga IKTK-ja, si dhe në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

C. Kuotizacioni vjetor i licencave

1. Kuotizacioni vjetor i licencave është një pagesë periodike vjetore që paguhet nga subjekti i licencuar, në vlerën 200 (dyqind) lekë.

2. Përfshihet nga pagesa e kuotizacionit vjetor subjekti, licenca e të cilit është pezulluar ose revokuar, si dhe subjekti që ndodhet në kushtet e pikës 5, ndarja D, e këtij kreu.

3. Të ardhurat e përfthuara nga pika 1, ndarja C, e këtij kreu, shkojnë në llogari të Fondit Kombëtar të Kujdesit të Trashëgimisë Kulturore Materiale.

Ç. Detyrimi i formimit të vazhdueshëm

1. Individit i licencuar ka detyrimin të kryejë formimin e vazhduar ose të marrë kreditet në përputhje me pikat 6 dhe 7, të nenit 82, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

2. Brenda datës 31 janar të çdo viti, individit i licencuar raporton pranë Sekretarisë Teknike mbi plotësimin e krediteve për vitin ushtrimor paraardhës, sipas parashikimit të pikës 1, të ndarjes D, këtij kreu.

D. Revokimi dhe pezullimi i licencës

1. Licenca revokohet me vendim të KKTKM-së, në rastet e parashikuara në pikën 1, të nenit 84, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, si dhe në rastet e mëposhtme:

a) në rastet kur në procedurat e konkurrimit publik të realizuara nga institucionet publike për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore, dokumentet e paraqitura nga subjekti i licencuar janë të rreme apo të falsifikuara;

b) në rastin e likuidimit të personit fizik ose juridik;

c) kur individit mbajtës i licencës humbet jetën.

2. Në rastin e parashikuar në shkronjën “b”, të pikës 1, të kësaj ndarjeje, subjekti duhet të paraqesë në Sekretarinë Teknike të KKTKM-së, pranë IKTK-së, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) njoftimin me shkrim nga përfaqësuesi ligjor për mbylljen e aktivitetit, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;

b) dorëzimin e licencës për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale që disponon;

c) dokumentin vërtetues nga QKB-ja për çregjistrimin e subjektit nga Regjistri Tregtar.

3. Për çdo rast të konstatuar nga DRTK-të ose IKMTK-ja, IKTK-ja harton një raport vlerësimi të fakteve dhe ia kalon për shqyrtim KKTKM-së, që merr vendim për revokimin e licencës për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale.

4. Licenca për kryerjen e veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale pezullohet me vendim të KKTKM-së:

a) me kërkesë të vetë subjektit,

b) kur titullari i licencës ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit ose ka ndonjë pengesë tjetër ligjore, me ushtrimin e funksioneve publike në përputhje me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, për periudhën kohore që ekziston shkaku që ka çuar në pezullim.

c) nëse në mënyrë të përsëritur paraqet projekte që janë në kundërshtim me ligjin dhe/ose aktet nënligjore.

5. Përpara marrjes së vendimit të pezullimit, KKTKM-ja, si rregull, urdhëron riplotësimin e kriterëve apo ndreqjen e shkeljeve të detyrimeve, brenda një afati të arsyeshëm, deri në ripërmbylljen e kriterëve apo ndreqjen e shkeljeve të detyrimeve.

6. Ndaj vendimit për pezullimin e licencës me kërkesë të institucioneve dhe vendimit për revokimin e saj mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Licencat për çdo individ, person fizik dhe person juridik, të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve ose nga KKTKM-ja përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të konsiderohen të vlefshme deri 6 muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Brenda këtij afati, subjektet duhet të bëjnë rinovimin e licencave me formatin e ri të kategorive, si dhe në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë vendim. Pas këtij afati, licencat e parinovuara janë të pavlefshme.

2. Të gjitha subjektet, të cilat kanë paraqitur kërkesat për licencë për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale dhe nuk janë shqyrtuar nga KKTKM-ja përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, duhet të dorëzojnë dokumentacionin plotësues, për të provuar plotësimin e kushteve për licencim sipas këtij vendimi, brenda afatit 31.12.2020.

3. Të gjitha kërkesat për licenca për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale dhe aktet formale në lidhje me to bëhen me pagesë, sipas tarifave të miratuara me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe ministrit përgjegjës për financat.

4. Të gjitha kërkesat për licenca për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale dhe dokumentacioni shoqërues do të dërgohen në formë fizike nëpërmjet shërbimit postar pranë Sportelit Unik/Sekretarisë Teknike të IKTK-së deri në kalimin e të gjithë procedurës në sistemin elektronik për aplikimin *online* në portalin *e-Albania*.

5. Ngarkohet KKTKM-ja për miratimin e formatit të licencave, të cilat konsiderohen dokumente me vlerë që i nënshtrohen prodhimit të posaçëm.

6. Vendimi nr. 58, datë 10.01.2018, i Këshillit Kombëtar të Restaurimit, si dhe çdo akt tjetër nënligjor që bie ndesh me këtë vendim, shfuqizohen.

7. Ngarkohet ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

KRITERET PËR MARRJEN E LICENCËS NË PROJEKTIM								
LLOJI	KATEG.	NËNKATEGORITË E LICENCAVE		EDUKIMI	VITE PUNE NË PROFESIONIN PËR TË CILIN ËSHTË DIPLOMUAR	EKSPERIENCË PUNE NË INSTITUCIONET E SPECIALIZUARA TË TRASHEGIMISË KULTURORE	SPECIALIZIME PROFESIONALE / KURSE LIDHUR ME NËNKATEGORINË (të kryera / certifikuar / të njohura nga Ministria e Kulturës)	AUTORËSI / BASHKAAUTORËSI NË HARTIM PROJEKTESH KONSERVIM - RESTAURIM SIPAS NËNKATEGORISË TË MIRATUARA SIPAS LEGJISLACIONIT TË TRASHEGIMISË KULTURORE
PROJEKTIM	ARKITEKTURË	P/A/1	Projektim në Konservim - Restaurim të rrënojave / Siteve arkeologjike Gjinjtë: 11 - vendbanime, 12- fortifikime, 13 - ndërtime kult, 14 - ndërtime social/kulturore, 15 - ndërtime inxhinierike, 16 - vendvarrime të çësura rrënoja arkeologjike, 17- zonifikime arkeologjike	Diplomë “Doktor” në Konservim dhe restaurim të rrënojave arkeologjike	5	0 vite Min. 5 vite 0 vite	0 orë 0 orë 120 orë	3 projekte (-2 P) 2 projekte (-1 P) 2 projekte (-1 P)
				Diplomë “Master i shkencave” në Konservim / restaurim	7	0 vite Min. 5 vite 0 vite	0 orë 0 orë 120 orë	5 projekte 3 projekte (-2 P) 4 projekte (-1 P)
				Diplomë “Master i shkencave” në Arkeologji, në Arkitekturë, në Urbanistikë, në Inxhinieri ndërtimi + Diplomë “Master profesional” në Konservim / restaurim	7	0 vite Min. 5 vite 0 vite	0 orë 0 orë 120 orë	5 projekte 3 projekte (-2 P) 4 projekte (-1 P)
				Diplomë “Master i shkencave” në Arkitekturë, Urbanistikë, Inxhinieri ndërtimi	7	Min. 7 vite 0 vite	0 orë 240 orë	4 projekte (-1 P) 5 projekte
				Diplomë “Master i shkencave” në Arkeologji	7	Min. 5 vite 0 vite	0 orë 120 orë	4 projekte (-1 P) 5 projekte
				Diplomë universitare e huaj, e njohur nga ministria përgjegjëse për arsimin e barasvlershme me diplomat e përmendura në pikat e mësipërme	Kriteret do të jenë sipas njësitit të kategorisë së diplomës të përmendura më sipër nga ministria përgjegjëse për arsimin			
				Diplomë “Doktor” në Konservim dhe restaurim të ndërtimeve me karakter mbrojtës	5	0 vite Min. 5 vite 0 vite	0 orë 0 orë 120 orë	3 projekte (-2 P) 2 projekte (-1 P) 2 projekte (-1 P)
		P/A/2	Konservim - Restaurim i ndërtimeve me karakter mbrojtës Gjinia: 21 - Kala/fortifikim	Diplomë “Master i shkencave” në Konservim / restaurim	7	0 vite Min. 5 vite 0 vite	0 orë 0 orë 120 orë	5 projekte 3 projekte (-2 P) 4 projekte (-1 P)
				Diplomë “Master i shkencave” në Inxhinieri ndërtimi, Arkitekturë, Urbanistikë + diplomë “Master profesional” në Konservim / restaurim	7	0 vite Min. 5 vite 0 vite	0 orë 0 orë 120 orë	5 projekte 3 projekte (-2 P) 4 projekte (-1 P)
				Diplomë “Master i shkencave” në Arkitekturë, Urbanistikë	7	Min. 7 vite 0 vite	0 orë 240 orë	4 projekte (-1 P) 5 projekte
				Diplomë “Master i shkencave” në Inxhinieri ndërtimi	7	Min. 5 vite 0 vite	0 orë 120 orë	4 projekte (-1 P) 5 projekte
				Diplomë universitare e huaj, e njohur nga ministria përgjegjëse për arsimin e barasvlershme me diplomat e përmendura në pikat e mësipërme	Kriteret do të jenë sipas njësitit të kategorisë së diplomës të përmendura më sipër nga ministria përgjegjëse për arsimin			
				Diplomë “Doktor” në konservim dhe restaurim të arkitekturës së kultit	5	0 vite Min. 5 vite 0 vite	0 orë 0 orë 120 orë	3 projekte (-2 P) 2 projekte (-1 P) 2 projekte (-1 P)
				Diplomë “Master i shkencave” në Konservim / restaurim	7	0 vite Min. 5 vite 0 vite	0 orë 0 orë 120 orë	5 projekte 3 projekte (-2 P) 4 projekte (-1 P)
		P/A/3	Konservim dhe restaurim i arkitekturës së kultit Gjinjtë: 22 - Arkitekturë kult, 25 - Varre monumentale	Diplomë “Master i shkencave” në Inxhinieri ndërtimi, Arkitekturë, Urbanistikë + diplomë “Master profesional” në Konservim / restaurim	7	0 vite Min. 5 vite 0 vite	0 orë 0 orë 120 orë	5 projekte 3 projekte (-2 P) 4 projekte (-1 P)
				Diplomë “Master i shkencave” në Urbanistikë, Arkitekturë	7	Min. 7 vite 0 vite	0 orë 240 orë	4 projekte (-1 P) 5 projekte
				Diplomë “Master i shkencave” në Inxhinieri ndërtimi	7	Min. 5 vite 0 vite	0 orë 120 orë	4 projekte (-1 P) 5 projekte
				Diplomë universitare e huaj, e njohur nga ministria përgjegjëse për arsimin e barasvlershme me diplomat e përmendura në pikat e mësipërme	Kriteret do të jenë sipas njësitit të kategorisë së diplomës të përmendura më sipër nga ministria përgjegjëse për arsimin			
				Diplomë “Doktor” në konservim dhe restaurim të ndërtimeve inxhinierike.	5	0 vite Min. 5 vite 0 vite	0 orë 0 orë 120 orë	3 projekte (-2 P) 2 projekte (-1 P) 2 projekte (-1 P)
				Diplomë “Master i shkencave” në Konservim / restaurim	7	0 vite Min. 5 vite 0 vite	0 orë 0 orë 120 orë	5 projekte 3 projekte (-2 P) 4 projekte (-1 P)
				Diplomë “Master i shkencave” në Inxhinieri ndërtimi, në Arkitekturë, në Urbanistikë + diplomë “Master profesional” në Konservim / restaurim	7	0 vite Min. 5 vite 0 vite	0 orë 0 orë 120 orë	5 projekte 3 projekte (-2 P) 4 projekte (-1 P)
		P/A/4	Konservim dhe restaurim të ndërtimeve inxhinierike Gjinia: 24 - Vepra inxhinierike	Diplomë “Master i shkencave”, në Arkitekturë, në Urbanistikë	7	Min. 7 vite 0 vite	0 orë 240 orë	4 projekte (-1 P) 5 projekte
				Diplomë “Master i shkencave” në Inxhinieri ndërtimi	7	Min. 5 vite 0 vite	0 orë 120 orë	4 projekte (-1 P) 5 projekte
				Diplomë universitare e huaj, e njohur nga ministria përgjegjëse për arsimin e barasvlershme me diplomat e përmendura në pikat e mësipërme	Kriteret do të jenë sipas njësitit të kategorisë së diplomës të përmendura më sipër nga ministria përgjegjëse për arsimin			
				Diplomë “Doktor” në Konservim dhe restaurim të arkitekturës së traditës (vernakulare)	5	0 vite Min. 5 vite 0 vite	0 orë 0 orë 120 orë	3 projekte (-2 P) 2 projekte (-1 P) 2 projekte (-1 P)

		P/A/6	Gjinitë: 25 - Arkitektura e traditës, 27 - Zonifikime	Diplomë “Master i shkencave” në Konservim / restaurim	7	0 vite Min. 5 vite 0 vite	0 orë 0 orë 120 orë	5 projekte 3 projekte (-2 P) 4 projekte (-1 P)
				Diplomë “Master i shkencave”, në Arkitekturë, në Inxhinieri ndërtimi, në Urbanistikë + diplomë “Master profesional” në Konservim / restaurim	7	0 vite Min. 5 vite 0 vite	0 orë 0 orë 120 orë	5 projekte 3 projekte (-2 P) 4 projekte (-1 P)
				Diplomë “Master i shkencave” në Urbanistikë, Inxhinieri ndërtimi	7	Min. 7 vite 0 vite	0 orë 240 orë	4 projekte (-1 P) 5 projekte
				Diplomë “Master i shkencave” në Arkitekturë	7	Min. 5 vite 0 vite	0 orë 120 orë	4 projekte (-1 P) 5 projekte
				Diplomë universitare e huaj, e njohur nga ministria përgjegjëse për arsimin e barasvlershme me diplomat e përmendura në rikat e mësipërme		Kriteret do të jenë sipas njësitit të kategorisë së diplomës të përmendura më sipër nga ministria përgjegjëse për arsimin		
				Diplomë “Doktor” në Konservim dhe restaurim të arkitekturës së projektuar	5	0 vite Min. 5 vite 0 vite	0 orë 0 orë 120 orë	3 projekte (-2 P) 2 projekte (-1 P) 2 projekte (-1 P)
			Konservim dhe restaurim i arkitekturës së projektuar Gjinia: 26 - Ndërtime të projektuara	Diplomë “Master i shkencave” në Konservim / restaurim	7	0 vite Min. 5 vite 0 vite	0 orë 0 orë 120 orë	5 projekte 3 projekte (-2 P) 4 projekte (-1 P)
				Diplomë “Master i shkencave” në Arkitekturë, në Inxhinieri ndërtimi, në Urbanistikë + diplomë “Master profesional” në Konservim / restaurim	7	0 vite Min. 5 vite 0 vite	0 orë 0 orë 120 orë	5 projekte 3 projekte (-2 P) 4 projekte (-1 P)
				Diplomë “Master i shkencave” në Urbanistikë, Inxhinieri ndërtimi	7	Min. 7 vite 0 vite	0 orë 240 orë	4 projekte (-1 P) 5 projekte
				Diplomë “Master i shkencave” në Arkitekturë	7	Min. 5 vite 0 vite	0 orë 120 orë	4 projekte (-1 P) 5 projekte
				Diplomë universitare e huaj, e njohur nga ministria përgjegjëse për arsimin e barasvlershme me diplomat e përmendura në pikat e mësipërme		Kriteret do të jenë sipas njësitit të kategorisë së diplomës të përmendura më sipër nga ministria përgjegjëse për arsimin		
				Diplomë “Doktor” në Konservim, restaurimin dhe rikualifikim i qendrave historike dhe ansambleve historike urbane	5	0 vite Min. 5 vite 0 vite	0 orë 0 orë 120 orë	3 projekte (-2 P) 2 projekte (-1 P) 2 projekte (-1 P)
		P/A/7	Konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rugë, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane Gjinia: 27 - Zonifikime	Diplomë “Master i shkencave” në Konservim / restaurim	7	0 vite Min. 5 vite 0 vite	0 orë 0 orë 120 orë	5 projekte 3 projekte (-2 P) 4 projekte (-1 P)
				Diplomë “Master i shkencave” në Urbanistikë, në Inxhinieri ndërtimi, në Arkitekturë + diplomë “Master profesional” në Konservim / restaurim	7	0 vite Min. 5 vite 0 vite	0 orë 0 orë 120 orë	5 projekte 3 projekte (-2 P) 4 projekte (-1 P)
				Diplomë “Master i shkencave” Inxhinieri ndërtimi, në Arkitekturë	7	Min. 7 vite 0 vite	0 orë 240 orë	4 projekte (-1 P) 5 projekte
				Diplomë “Master i shkencave” në Urbanistikë	7	Min. 5 vite 0 vite	0 orë 120 orë	4 projekte (-1 P) 5 projekte
				Diplomë universitare e huaj, e njohur nga ministria përgjegjëse për arsimin e barasvlershme me diplomat e përmendura në pikat e mësipërme		Kriteret do të jenë sipas njësitit të kategorisë së diplomës të përmendura më sipër nga ministria përgjegjëse për arsimin		
				Diplomë “Doktor” në restaurimin e mozaikëve	5	0 vite Min. 5 vite 0 vite	0 orë 0 orë 120 orë	3 projekte (-2 P) 2 projekte (-1 P) 2 projekte (-1 P)
	VEPRA ARTI	P/V/1	Konservim dhe restaurim i mozaikëve Tipologjia: 3204 - Mozaikë	Diplomë “Master i shkencave” në Konservim / restaurim të veprave të artit	7	0 vite Min. 5 vite 0 vite	0 orë 0 orë 120 orë	5 projekte 3 projekte (-2 P) 4 projekte (-1 P)
				Diplomë “Master i shkencave”: PIKTURË, SKULPTURË, KIMI, BIOKIMI, HISTORI, ARKEOLOGJI + diplomë “Master profesional” në Konservim dhe restaurim e veprave të artit	7	0 vite Min. 5 vite 0 vite	0 orë 0 orë 120 orë	5 projekte 3 projekte (-2 P) 4 projekte (-1 P)
				Diplomë “Master i shkencave”: Pikturë, Skulpturë, Kimi, Biokimi, Histori, Arkeologji	7	Min. 7 vite 0 vite	0 orë 240 orë	4 projekte (-1 P) 5 projekte
				Diplomë universitare e huaj, e njohur nga ministria përgjegjëse për arsimin e barasvlershme me diplomat e përmendura në pikat e mësipërme		Kriteret do të jenë sipas njësitit të kategorisë së diplomës të përmendura më sipër nga ministria përgjegjëse për arsimin		
				Diplomë “Doktor” në Konservim dhe restaurim të pikturave murale	5	0 vite Min. 5 vite 0 vite	0 orë 0 orë 120 orë	3 projekte (-2 P) 2 projekte (-1 P) 2 projekte (-1 P)
				Diplomë “Master i shkencave” në Konservim dhe restaurim e veprave të artit	7	0 vite Min. 5 vite 0 vite	0 orë 0 orë 120 orë	5 projekte 3 projekte (-2 P) 4 projekte (-1 P)
